

KUJTIM M. SHALA

CAMAJ I (PA)ZBULUEM
(Hyrje në poezinë e Martin Camajt)

I. CAMAJ I (PA)ZBULUEM

Nën titullin *Camaj i (pa)zbuluem* do të lexohet poezia e Martin Camajt nga fillimi, për të ritakuar autorin e njohur e për të rihapur poezinë e tij.

Kërkimi i tillë përherë ka parasysh leximet e hershme e të përhershme të Camajt dhe komunikon me poezinë e tij tash e këtu, me sensibilitet e subjektivitet të ri. Është ky leximi personal, që është provuar të jetë dhe universal.

Kërkimi nis nga emërtimet e librave, nga figura, për të rënë tek emocioni ose për ta arritur mendimin. Shtrihet nëpër format e poezisë dhe mbyllet në një interpretim të saj. Kështu formulohet poetika e kësaj poezie dhe hyhet në një hermeneutikë të hapur; shpalosen format e (ri)zbulohen kuptimet, për të dhënë Camajn e (pa)zbuluem.

Vetë titulli i këtij teksti shpie te formulimi i Camajt për Mitrush Kutelin, *Kuteli ende i pazbuluem*. Camaj e shpallte Kutelin ende të panjohur (të pazbuluem), jo në kuptimin biografik, por në atë të njohjes së tekstit e të karakterizimit të veprës së tij, me një fjalë, në rrafshin e poetikës. Këtu do të ecim nga poetika te hermeneutika, për të lexuar e për të provuar që autorët, pikërisht në këtë plan, asnjëherë nuk zbulohen përfundimisht.

Ndërsa, trajta në gegnishte *i (pa)zbuluem* shenjon mallin për gegnishten e Camajt dhe lidhjen tonë emocionale e kulturore me të.

Camaj e nisi jetën letrare me poezinë, u bë i njohur përmjet botimeve në revistën e Prishtinës *Jeta e re* dhe me librat e parë: *Nji fyell ndër male* (1953) e *Kanga e vërrinit* (1954).

Duke patur parasysh dy librat e tij të parë, ai veçohet si Poet i Prishtinës. Vërtet, Camaj iu rikthye sa herë librave të Prishtinës, për t'i matur më tej me forcën e artit të ri. Vetë ribotimet dëshmojnë se Camaj tërë jetën mbeti Poet i Prishtinës. Kjo shpie tek ideja se ai pati një poetikë të veten, të lakuar e të përthyer gjatë gjithë jetës, sa herë që zbuloi tema të reja ose sa herë shtriu më tej aventurën e zbulimit e të sprovimit të formave. Kjo sepse një kapërcim nga figura e ngarkesës idiomatike, te simbolet e forta, te metaforat mbretërore, s'është pos një kapërcim nga

gjuha e parë te sprovimet e thella të saj. Në kapërcimet e tilla, teksti i Camajt, nga ligjërata e hapur, shtrihet e mbyllet në struktura e figura që mbajnë e japin kuptime të përthella. Leximi i tillë provon se fazat e poezisë së Camajt, vërtet janë faza që vë leximi i veprës së tij. Ndërsa, ai gjithë jetën shkroi në qarkun e një poetike. E njohim këtë si poetikë të rrënjës së shkollës shkodrane, të gegnishtes së rrallë, edhe të temave fishtiane e të disurseve koliqiane, të amzës së shkrimit modern të Kosovës.

Camaj i pazbuluem është Camaj i mësuar e i kultivuar në traditën shkodrane, geqe, gjë që e provojnë edhe tekstet e tij të para. Ai shkroi temat e vendit në trajta klasike. Vetëm figura idomatike shfaqet aty si një kujtesë e përmallim, në thyerjet e saj përballë formave moderne. Frazelogjia është tretur në stil të mësuar e të kultivuar që në tekstet e para të tij.

Camaj i pazbuluem është Camaj i sistemeve/strukturimeve poetike më shumë a më pak të forta. Sistemi është shenjë e madhe e autorit të mësuar e të kultivuar, shenjë e vetëdijes së krijimit. Ky sistem duket qysh te *Nji fyell ndër male*, që Camaj e ndërton si një poemë, që lidh tekstet tematikisht, po edhe si një histori dashurie e jete të rrëfyer në shrirjen e ditëve e të stinëve.

Camaj i pazbuluem është Camaj i stilit të zgjedhur, që ka rrënjët në idiomën e Martinit, në gegnishten e folur, në gegnishten e shkruar, në librat, në kulturën letrare e ditunore të tij. Po, stili është emocion i strukturuar, i shkruar, emocion i përjetësuar në shenja e struktura të zgjedhura me mall.

Camaj i pazbuluem shfaqet përfundimisht kur kërkohen kuptimet e tundimet e tij, të mbyllura teksteve, në të gjitha shenjat, nga tingujt te figurat, nga vargu te strofa, nga teksti te tekstet e lidhura. I tillë, Camaj lexohet dyfish, në struktura të veçanta e në *strukturën e madhe*, në veprën si tërësi a rrjet.

II. POEZIA

II. 1. Librat e parë

Dy librat e parë poetikë, *Nji fyell ndër male* dhe *Kanga e vërrinit*, që Camaj i botoi në Prishtinë, janë librat e identitetit të këtij poeti, në planin e stilit e të formave përgjithësisht, po edhe sa i takon qarkut tematik të veprës së tij. Janë libra të një fryme, të një klasiciteti të zgjedhur, libra që bëjnë Portretin e Camajt në rini dhe vijëzojnë qoftë edhe Portretin e Camajt në pleqëri. Camaj i shkroi një herë këta libra dhe i rishkroi përherë, qoftë edhe duke i rigjetur në libra të tjerë. Përpos bibliografisë, që gjen të jenë ripunuar këta libra te *Legjenda, Lirika midis dy moteve e Poezi 1953-1967*, leximi i zbulon ata edhe në palët e *Njeriu më vete e me tjerë* e te

Dranja, herë në figurë e strukturë, herë në tematikën “e vjetër” të Camajt a si amzë e temave të reja.

Titujt e dy librave të parë shenjojnë ambient: *Nji fyell ndër male*, *Kanga e vërrinit*, *male e vërri*, të përfaqësuar nga *fyelli e kanga*, që janë variante të ndërsjella e që shenjojnë këngën, poezinë, dëshminë a jetën e kënduar. Këngë të ambientit, do të thoshim. Mali e vrrini shoqëruan poezinë e Camajt përherë, pa u artikuluar me emfazë, por si mall i heshtur e i përhershëm. Ambient e mall që janë bërë figurë, që mbajnë emocionin a nisen drejt mendimit. Janë emocione gjenuine e mendime të kultivuara. Camaj lidhet tematikisht përjetë me këtë gjënuinitit, por ndahet në planin stilistik e poetik përgjithësisht. Stili mban sensibilitetin e tij. Ky shtyn Camajn nga një klasicitet i poezisë moderne.

Nji fyell ndër male ka strukturën e një poeme të thurur nga tekste integrale e njëkohësisht të lidhura. Secila poezi është e përfunduar, e mbaruar, e përmbyllur. Secila rihapet në poezinë vijuese, për të krijuar një lidhje poetike e tematike të të gjithë veprës. Lidhja e tillë e shpie këtë vepër drejt konceptit të librit poetik, të librit të konceptuar e të strukturuar. Sistemi i tillë sugjeron leximin e lidhur si lexim final. Leximet e teksteve veç e veç, bëhen lexime të pamjeve të veçanta të një mozaiku të madh të jetës, dashurisë e të vdekjes në ambientin autentik shqiptar.

Struktura e tekstit, lirkat e lidhura ta kujtojnë *Milosaon* e Jeronim de Radës e *Mili e Hajdhia* të Zef Skiroit, si dy poema të hapura, si vepra që shpalosin “historinë” si emocion e figurë, pa rrëfyer në struktura narrative, pa krijuar zinxhir suksesiv. Provohet kështu dhe një dashuri e hershme e Camajt për letërsinë e për kulturën arbëreshe.

Po kjo strukturë sjell në mendje tekstet e një autori të madh të traditës shkodrane, Ndre Mjedja. Vërtet, Camaj shtyhet edhe te temat e figurat e Mjedjes, te shkolla e kërkimit dhe e kultivimit të formës së tekstit. Një traditë kjo e vyer fort.

Në aventurën e vet retorike të strukturimit të librit, Camaj niset nga piketimi i shenjave të ambientit, për të provuar autenticitetin e tij: fyelli, katundi, qarri, mokna, kroi, që janë edhe tituj tekstesh. Këto janë shenjat që identifikojnë ambientin, topose që shenjojnë jetën e këtij ambienti, topose në të cilat shtrihet jeta, njihet thellë dashuria e mbështjell egër ftohtësia e vdekjes. Një fyell që këndon jetën e shkuar e të tashme, që përcjell trashëgiminë e këtij ambienti, shenjat e tij të mëdha e të vogla. Katundi si bërthamë e kësaj jete. Qarri si vend kuvendi e si shenjë që dëshmon ndodhi. Mokna, figura e bukës që fitohet me mund të zi. Kroni, toposi tradicional i jetës së re, i takimeve, dashurive, ndarjeve, vendi i ëndrrave të mëdha a i ndarjeve të përjetshme.

“Historia” e poemës shtrihet në këtë ambient, përcaktohet nga ky ambient, përplasat me të dhe përmbillet duke ikur nga ai. Është kjo një histori dashurie, e lakuar si histori e jetës së ambientit verior shqiptar, të përcaktuar thellë nga kodi tradicional. Luli e Zana, të një fisi, lidhin zemrat në dashuri, rriten me të dhe ikin nga vendi për ta mbrojtur shpirtin e tyre.

Gjithë kjo thuret në disa variante formale, gjithnjë brenda poetikës klasike metrike e letrare përgjithësisht. Vargu është herë më i shkurtër e rrjedh më shpejt, herë më i shtrirë e më i ngadalshëm, por aspak më i qetë. Ngjyrimet e diskursit lëvizin nga një ton baladik, nëpër elegjinë, te tonet e gëzimit të një jete të re.

Figura buron nga idiomi, por rrallë formulësohet. Ajo përthihet në gjuhën e librit, në gjuhën e kultivuar të teksteve geqe, e të poetikave klasike. Idiomi forcohet kur situata bëhet ambientale. Sa herë rrëfëhet historia shpirtërore e Lulit dhe e Zanës, teksti merr shenjat e diskursit universal të dashurisë, përthihet nëpër autorin e tekstit dhe mban e jep fuqishëm dorën e tij.

Historia e tekstit vishet e shoqërohet edhe me një tip ideologjie, që hapet përfundimisht te teksti i fundit i librit, i titulluar *Ikja*. Është kjo ideologjia e jetës së re, e thyerjes së kodit tradicional, për të dalë nga konvenca që rregullon, por dhe që ndalon, në rrugën e zgjedhjeve të shpirtit. Po ideologjia s’bëhet deklaratë dhe teksti i shpëton kapjes nga funksioni i pastër social. Camaj s’është zë i jetës së re sociale, sepse zëri i tillë s’është zë i politikës. Duket e pabesueshme sa jo e politikës është e gjithë vepra e Camajt. Ideologjia e tekstit të tij sundohet thellësisht nga poetikja. Ndaj, kërkohen lexime të poetikës, të finesave të gjuhës e të kuptimeve që bën gjuha.

Për të përjetuar sensibilitetin e tekstit, pra sensibilitetin e Camajt, figurën e strukturat, po lexojmë edhe këtu një poezi nga *Nji fyell ndër male*.

Martin Camaj
Dhimba e Zanës

*Kur n’vorre Zana pau për ball katundin
Gjindjen me nanën e Lulit në vig,
Shtati iu rrqeth e ‘i vaj, që del prej fundit
T’shpirtit i shkoi n’për faqe t’saja rig.*

*Deri atëher’ çdo lot pat ndry në veti
Që shkas mos t’jepte kuj me e përgojue,
E zemra peshë iu ngrit si n’dallga det*

Camaj i (pa) zbuluem

N'sa po mendonte djersa e ftoft' tu' e mblue:

*- E mnershme â vdekja mâ se vjeshta e shtyme,
Kur krejt blerimet zverdhen edhe vdesin,
Kur bukurija rrin në tokë e ndryeme,
Picak shkambijt e drujt ndër pyje mbesin.*

*Vdekja kob âsht! tash shpín e Lulit mbylli!
Iu ul te votra një hije e zez' - vetmija.
N'buz't e djalit mbi zâ s'do t'bij mâ fyelli
Ashtu si verës n'maje t'nalta e brija.*

*Shpesh herë, e mjera! me vedi mendova
Nji koh' ma t'lume me Lulin me protë;
"Nanë" me ia thirrur t'amën dishrova,
"Nan'", me i belbzue do f'mij një ditë...*

*N'shpirt viente Zana n'kto mendime e tjera
Edhe lotja prej syve t'saj s'iu shtjerr,
Ndej' tue kundrue n'oborr të vet te dera
Deri që u muzg e vorret mbetne n'terr.*

*"Qindrò, mos Zanë, e mbushun me pikllime,
Moj bija e gurit, që mâ ngusht s'e pate,
As kur në mal të shndrite prej vetime
N'terr ftyra e jote frigsue shtërgate!*

*Mos t'lodhin vdekjet as pse thahet bari;
Si n'brigje t'lumit prore rrin i blerë
Bushit qindrues, dullija e fortë e lari
Dashnija n'zemër asht blerim përherë.¹*

Kjo poezi sjell në një vend baladën e elegjinë e Camajt, dhembjen e vdekjes, tërë ftohtësinë e saj, dhe shpresën e zemrës së pruar në dashuri.

Kanga e vërrinit ruan sensibilietin e veprës së parë, por e përthyen atë në planin tematik, duke i dhënë edhe një notë sociale. Madje, vepra merr pamjen e një poetike të sociumit, të idiosociumit, të përfaqësuar me figurën e vendit, me gjuhën e me jetën autentike.

Format, si edhe gjuha, ecin drejt një thjeshtësie e elementariteti, tipik për diskursin që merr përsipër të përfaqësojë ndodhi, vende, ideologji etj.

¹ Martin Camaj, *Nji fyell ndër male*, "Mustafa Bakija", Prishtinë, 1953, ff. 59-60.

Por, të nënvizohet menjëherë, shenja tematike sociale, edhe këtu, nuk e fut tekstin e Camajt në shërbim, meqë atij i mungon shenja e politikës. Camaj ligjëron e gjëmon me mall, ai dëshmon e nuk bën kritikën sociale. Ideologjia e tij është ideologji e dëshmisë poetike. Kjo vetëm sa ka dobësuar figurën dhe ka mbajtur kuptimet në sipërfaqen e gjuhës.

Ky libër edhe stukturalisht dallon nga *Nji fyell ndër male*, meqë nuk i ruan strukturat e lidhura të librit të parë, nis të zgjidhë format dhe i ikën unitetit tematik. Tekstet e lidhura të të parit janë bërë tekste të veçanta të një vëllimi/albumi poetik. Sistemi poetik ka kaluar në përbashkim të pastër tematik të vjershave në një vëllim. Ato janë vjershat e Vërrinit, që më shumë duan të mbajnë e të japin emocionet për toposin, se sa një sistem poetik.

Përballë *Nji fyell ndër male*, *Kanga e vërrinit* sikur ka zbutur edhe klasicitetin e formave, duke ndjekur shpesh, më parë se strukturat metrike, frazën që s'mbaron në një varg, po shtrihet në tjetrin, që bart kuptimin përtej një strukture metrike. Këtu sikur projektohen format e poezisë së Camajt në tërë shtrirjen e saj. Kjo nuk ka si të thuhet me këtë forcë për planin semantik të kësaj poezie, që gjithnjë vjen duke u përbrendësuar, duke u bërë më i thellë, më i ngarkuar; dikush tha hermetik.

Kanga e vërrinit është libër i mallit për kalesën, për jetën, sendet e shenjat që kanë mbetur prapa, për toposet e njerëzit e bërë kujtim. Teksti lidh këto kujtime në një mozaik pamjesh e shenjash. Në këtë kuptim, *Kanga e vërrinit*, edhe pse duket paradoksale, kur kemi parasysh shenjën e tij sociale, bëhet një libër shumë personal, shumë më personal se libri i parë. Emocioni shpesh pamundëson figurën e mendimin, por asnjëherë nuk rrëshqet në emfazë. Kujtimet e Camajt hapen të tajitura, të shtruara e të shkruara në shenjat e palat e gjuhës poetike.

Kanga e Vërrinit është kënga për jetën autentike, të përthyer në gaz e dhembje, që shkruhet me figurat e vendit, të matura me diskursin e mësuar të autorit. Kjo jetë vë përballë brezat, kujtimet e konkretësitë, njësinë e vendit e përthyerjet e saj. Jetën, me shenjat e veta, vdekjen, të pangjarë me vdekjen gjetkë. Një mikrokozmos, që përkundet në pikën e kujtimit e të ndarjes nga vetja autentike, disi mitike. Por, Camaj aty s'hyn të zhveshë mite, ai vetëm sa shenjon dramën. Se ai e di që etika e letërsisë është poetike dhe po kaloi në etikë shërbimi, e vret vetë shpirtin e saj.

Kënga e Camajt hap filozofinë e jetës së Vërrinit, të jetës autentike, të përthyer në konkretësi sociale, e të mbuluar me emocion, pastaj me figurë. Kur mbërrihet figura, Camaj ta kujton edhe një herë një mësues të hershëm të autorëve të kultivuar shqiptarë, Ndre Mjedjen. Të dy e provojnë se autentikja mund të ringjallet në figurat e në strukturat universale të

Camaj i (pa) zbuluem

poezisë, pa i tretur shenjat e veta, për të provuar shkallë të kultivimit e të universalizimit. Kështu kalohet nga rrëfimi për topose, te poetika e toposit, nga dega e një lisi, tek ideja e degës, nga vdekja në një vend, te dhembja njerëzore për kalesën. Martin Camaj ruajti përherë një rend temash autentike, meqë e dinte që ato shpjen pandalë tek universaliet, për t'i dhënë jetë veprës përtej toposit e kohës së parë.

II. 2. Njeriu më vete e me tjerë

Martin Camaj

Fill i gjetun

*Natën që shkoi u ndalën dritat e mbeti
qyteti në terr deri n'agim.*

*Amvisat kërkuan llampat vajguri
e s'i gjetën në terr.*

*Në nadje ra dielli e zbeu
faqet e rroqaqiellëve.*

*Në nadja vrejta rrethin e andrrave
në truall
e gjeta fillin e tretun
në pikën e ndaljes së dritës.²*

Kjo është poezia e parë e *Njeriu më vete e me tjerë* (1978), poezia që shenjon karakterin personal të veprës, një kthim të autorit nga vetja, për të kërkuar rrethin e ëndrrave, fillin e tretur të tyre. Poezi që zbulon autorin rishtas e që shenjon diskursin personal të veprës. I tillë, *Njeriu më vete e me tjerë* është libër i përndriçimit të ri e të vjetër të Camajt. Një hapje në vete e për të tjerët.

Figura e kësaj poezie shenjon figurat e tërë vëllimit, të kërkuara gjatë, të kultivuara si përgjasime të largëta, të lidhura fort në struktura të figurshme. Përgjasimet e tilla përcaktojnë natyrën semantike të tekstit, kuptimet e largëta, të thella e të befta, disi më të errëta.

Që këtu hapet loja me tingujt, trajtat gjuhësore e me format në përgjithësi, që kap gjithë vëllimin e që prodhon tingëllimën, trajtat e bukura gjuhësore/poetike dhe një larmi strukturash e formash letrare.

Secila poezi, si dhe secili titull, jep një gjendje të veçantë të Njeriut më vete. Në secilin tekst kërkohet e zbulohet një ndjesi e veçantë, që s'ka të

² Martin Camaj, *Njeriu më vete e me tjerë*, München, 1978, f. 7.

bëjë me kohën e vendin, por me psike-në e Njeriut. Secila faqe zbulon një pamje të përbrendshme të tij. I gjithë vëllimi lidh fillin e humbur të ndjesive dhe jep Njeriun më vete.

Po, titulli i këtij vëllimi është *Njeriu më vete e me tjerë*, titull që shenjon një raport: *unë - të tjerët*. Si vihet ky raport, si bëhet me të tjerë ai që është Njeri më vete?

Është teksti që i lidh, një komunikim i rrallë, që provon ngashërimet e Njeriut më vete si gëzime, kur ato u përcillen të tjerëve. Në këtë komunikim, Njeriu më vete hapet për të tjerët, bëhet me të tjerët, rrëfen veten e çlirohet nga brenda. Por, edhe fiton jetë të tjera, që ngjallen sa herë që lexohen tekstet e tij. Tashmë kemi prekur figurën e thellë të Camajt: Njeriu më vete jeton përherë, se përherë ka të tjerë që nisen ta njohin në veprën e tij, në faqet që mbajnë psike-në e tij. Camaj ia kushton librin gruas, Erikës, për të hapur që këtu jetën e veprës me të tjerë.

Njeriu më vete e me tjerë është vëllim i përbërë nga poezi të zgjedhura të një numri ciklesh në dorëshkrim. Nuk ka një strukturim sipas kohës së shkrimit të poezive e as sipas një parimi të fortë tematik. Tekstet janë zgjedhur për të përfaqësuar secili gjendje të veçantë, ndjesi të veçantë. Sistemi poetik është braktisur, për të zgjedhur. Po, zgjedhja ka dhënë një vëllim të hapur dhe pëlqimet e autorit. Këtu Camaj mbetet përzgjedhës, pa u bërë strukturues sistemor. Poetika e *Njeriu më vete e me tjerë* duhet të kërkohet te tekstet e veçanta, te larmia e formave e jo te një retorikë strukturuese e librit. Jo *një poetikë* unike, por *poetika* që përfaqësojnë variante shkrimi. Poetika më vete e me të tjera.

II. 3. *Dranja*

Dranja është libri më i lexuar me zë i Martin Camajt e më i hapuri. I shkruar gjatë, 1975-1979 e i botura më 1981, *Dranja* është vepra e aventurës totale të Camajt në lojën jetësore me format letrare e me kuptimet.

Tekst i shkruar ngadalë, libër i stilit të kërkuar, i trajtave të zgjedhura, i strukturave dhe i kuptimeve simbolike. Vepër që bën bashkë e që artikulon ndryshe gjithë veprën e mëparshme të Camajt, duke kryqëzuar përnjëherë tema e diskurse të kësaj vepre. Një libër-sintezë i ideve dhe i shkrimit të Camajt, përtej një forme letrare.

Vetë autori e përcakton veprën si *Madrigale mbi një frymor të papërsosun*. Nga këtu, po edhe nga titulli, nis shenjimi i kuptimeve të thella të tekstit, nis determinimi i *teoremës* nga *aksioma*, por edhe shenjohet leximi i kërkuar nga autori, që do kapërcimin e lidhur nga forma tek idetë. Kjo vepër e Camajt nuk është ndërtuar në madrigale të trajtës

tradicionale, në vargje, po në prozë, dhe ato s'i determinon rangun formal, por struktura e plani tematik. Është kjo struktura e shtresuar palë-palë, si një palimpsest tekstori e semantik, në të cilin shenja, forma, *aksioma* përcakton kuptimet.

Forma e tillë e madrigaleve të Camajt, i vë ato përballë formës tradicionale, siç vihen format moderne përballë arkiformës së vet. Në raportet e tilla ka kujtesë e përthyerje, sado që përherë pretendimet janë për të dalë nga rrafshi i kujtesës në rrafshin e formave të pangjashme.

Termi *madrigal* gjithnjë shenjon trashëgiminë e formës, edhe kur shmangiet duken haptas, si te teksti i Camajt. Kjo trashëgimi shpie te teksti i kënduar, te kënga, te trajta polifonike e saj. Edhe në këtë kuptim, përcaktuesi *madrigale* këtu shenjon tekstin polifonik, tekstin e ndërtuar nga disa tekste njëherësh, rrjetin e fortë intertekstual, tekstin që dialogon me tekste të tjera përbrenda trupit të vet, por edhe me rrethinën tekstore e kulturore, duke nisur nga ajo etnografike. Me një fjalë, termi *madrigal* te Camaj shenjon vetë statusin prej *palimpsesti* letrar të kësaj vepre.

Po kjo trashëgimi tërheq vëmendjen te format e tekstit, te struktura fonetike/poetike, te gjuha përgjithësisht, për ta parë çdo tingull, strukturë e tekstin integral me funksion të veçantë gjuhësor e semantik, pra letrar. Çdo tingull ka një funksion të vetin, integral, por edhe të lidhur me funksionet e rrjetit tekstori. Çdo strukturë e bën/thotë veten, por edhe dialogon me të tjera, për ta bërë e thënë tekstin. Secili madrigal është një tekst integral, pastaj lidhet me të tjerë, për të dhënë një tërësi tekstore e tematike të veprës, përfundimisht tërësitë e tilla japin veprën e Camajt në tri pamje, si: *Përvojë jete*, *Mprehje shqisash*, *Fryma e ngujume në asht*. Vetë titujt shenjojnë një kapërcim nga njëra tërësi te tjetra, pra një lidhje poetike e semantike, nga përvoja te trashëgimia a kujtesa. Kështu, secila pjesë jep një cikël jete a kujtese.

Po kujtojmë edhe këtu se themelore për Camajn është fjala e bukur, gjuha poetike e zgjedhur. Kjo i jep tekstit të tij frymë të një trashëgimie simboliste. Përqendrimi te gjuha poetike, duke nisur nga plani fonetik i saj e deri te kuptimet, ka reduktuar strukturën narrative të tekstit. Camaj më shumë shpall emocione e ide, se sa që thur një ndodhi rrëfimtare. Disi përgjasueshëm me Koliqin e *Pasqyrave të Narçizit*.

Camaj zgjedh figurën, strukturat e figurshme, tekstin e mbyllur në formë e të hapur semantikisht. Si një trashëgimtar modern i simbolistëve a si një jezuit i pashpallur shqiptar, e bën tekstin të rrëshqitshëm e bishtnues, edhe kur e ndërton mbi struktura të përsëritura të idomit e të etnokulturës. Sa hapet një derë, përtej shtrihen mjegullnajat e arta të tekstit të Camajt. Kuptimet lëvizin, kryqëzohen, kombinohen, vihen e mbivihen paprerë, për

të megjulluar përfundimisht kapërcimet nga një tip teksti në tjetrin, nga një strukturë e trashëguar te tjetra, për të prishur çdo kufi ndërmjet arkistrukturës e strukturës së tekstit. Ndaj, teksti i Camajt thuret e hapet si një rrjet tekstesh, që dialogojnë, konstruktojnë e dekonstruktojnë njëri-tjetrin pandalë. Teksti i tillë afrohet a largohet gjithnjë, shtrihet për t'u mbushur kuptime, rrjedh tutje te kuptimet e tjera dhe në fund të kthen në fillim. Leximi i këtij teksti është vetëm *një* lexim, një aventurë e mendjes dhe e shpirtit. Aventurë që zbulon autorin e që pranon që ai vetiu fshihet sërish. Camaj i (pa)zbuluem.

Por, si thuret kjo jetë në tekstin e Camajt, ç'kuptime merr e jep? Kështu po hyjmë në fushën e interpretimit të tekstit, gjithnjë duke patur parasysh format e tij.

Dranja është tekst i hapur semantikisht, si strukturalisht. Kuptimet shtresohen e lidhen në rrjete intersemantike, që kërkojnë lexime të hapura. Duket që leximi i cili do të jetë final, është përherë i humbur përballë këtij teksti. Kjo e bën këtë vepër të re para secilit lexim, vepër që synon të matet me kohët që vijnë, duke jetuar vetë në *kohën zero*, në kohën universale të shkrimit.

E lexuar si histori e një frymori të papërsosun, *Dranja* hapet si rrëfim me origjinë te rrëfimet ambientale e etnike, si një rrëfim simbolik, i ngjallur përmbi kujtesën mitike e mistike të vendit, por që matet me kujtesën mitike universale. Rrëfimi i tillë shtrihet përthellë shtresës së parë tekstore e përtej saj, në kuptimet e kumtimet që merr e jep ky rrëfim në kohë, vende e kultura.

Por, *Dranja* është edhe emri i lules/grua e *Dranja* - rrëfimi për lulen/grua. Gruaja është shenjë ekzistence, shenjë vendi e shenjë shpirti. Rrëfimi për jetën e saj, është rrëfim për raportet e jetës e të botës, duke nisur nga pamja që marrin raportet e tilla në ambientin shqiptar. Dhe, këtu, Camaj, ky shkrimtar aspak i jopolitikës, nuk ka si të mos jetë një autor sociologjik. Qarku i tillë kalohet, sa herë rrëfet psikografia e simbolit/figurës/personazhit dhe Camaj bëhet një rrëfimtari shpirti.

Dranja ka shenjën e rrëfimit të rrugës nacionale, që e bën rrëfim letrar historik e ideologjik, si secilin tekst të ideve. Camaj mbulon idetë në rrëfimin simbolik e në struktura që rrallë shpërthejnë në artikulime të hapura të copave të mendimeve të ideologjisë autoriale/nacionale. Vetë rrëfimi simbolik bën që historia të jetë një shtresë në rrjetin tekstual të kuptimeve e të ideve. Historia e tillë, e parë në figurën e një frymori të papërsosun, është rrëfimi për frymën, gjëllimin e vështirë, që shoqërohet me dhembjen e mbuluar autoriale. Dhembja bën që kritika të mos thuhet edhe kur shkruhet, që Camaj të mbetet i paangazhuar. Ai do që leximi t'u

japë jetë ideve, kur e ka këtë fuqi, ose të provojë pafuqinë e tij në lexime të lehta ideologjike.

Asgjë më shumë se vetëdijen për të ikur nga leximet e klasës së dytë rreken të shenjojnë nënvizimet që bëjnë këtu.

II. 4. Palimpsest

Martin Camaj
Emnimi i sendeve

*Etnit tanë në vetmi i thirrën shpirtën
shkëndijat e zjarmit dhe gjurmën e vet
të gdhendun në gúr Drangue ose Shêjt.*

*Ata ishin njerëz të dhanun mbas tingujsh
dhe me mija zane në krye:
ata ishin bletë që bijve tyne sot
u bien ndër karta të gjitha pa krena
që i kërkojnë me i gjetë kudò
ne tekste të hueja të lashta e thellë
në pergamena gjithkund në Biblioteka.*

*Etnit, me fjalën e saktë 'shêje' emnuen
vetëm hyjzit në qiell pse ishin larg.³*

Palimpsest (1991) shtrin teorinë e palimpsestit shqip dhe shenjon kërkimin e identitetit palëve të tekstit, përhellë asaj që duket në tekstin e parë, në tekstet e shuara nën të. Po, edhe teorinë e poezisë si një palimpsest, si tekst i mbindërtuar, plot kujtime të shuara në trup, që presin të zbulohen, të ringjallen në leximet e thella. Palimpsesti, kështu, shenjon ekzistencë (gjendje) teksti, por edhe një poetikë shkrimi.

Palimpsesti shenjon kujtesën e tekstit, rrjetin intertekstual, tekstet, diskursat e kuptimet që mbivihen e që kryqëzohen. Teksti i tillë është i hapur, tregon dhe, në të njëjtën kohë, fsheh *shenjat*. Ai do leximin që ka vetëdijen se shenjat përherë ndodhen larg e thellë. Janë këto shenjat e para të tij, të identitetit, të origjinës a të njësisë.

Poetika e tillë, e projektuar te teksti shqip, shenjon kërkimin e shkrimit të lashtë shqip si palimpsest, si (dorë)shkrim të fshirë e të mbuluar nga shkrime të tjera, më të reja. Identitetin e faqes së shkruar e mban pikërisht

³ Cit. sipas Martin Camaj, *Palimpsest*, "Camaj-Pipa ", Shkodër, 2005, f. 16.

teksti i mbuluar. Origjina pret që të zbulohet përherë dhe hapet kur bien lëvozhgat që e mbajnë mbyllur.

Camaj dëshmon se tekstin shqip si shtresë të palimpsestit ka nisur ta kërkojë kur po studionte *Mesharin* e Gjon Buzukut, në Romë, ndërmjet viteve 1956 e 1961. *Palimpsest* rrëfen e thur një poetikë mbi këtë përvojë.

Po përtej tekstit? Kërkohet tingulli, zâni, kânga. Zâni është kujtesë, dëshmia e jetës dhe e ekzistencës. Me të dalë zâni, d.m.th. me të mbaj të mend, me u përmend.

Është tingulli, pastaj teksti i fiksuar në grafema. Shkrimi vihet si palimpsest i tingullit, si lëndë që e mbulon atë, si gëzhgjë që duhet të çahet, për ta dëgjuar kângën. Se zâni është kujtesa më lashtë e jetës dhe e tekstit.

Martin Camaj

Shtresa nën landë është tingulli

Fryma, flitet se ajo është e ngjueme

në zonën arkeologjike

mbrenda një guri të brishtë e me dej të kuq.

Kur shpërthen lulja iris pranë e i bie dielli,

fryma del jashtë e endet ndër rrënoja shlrshëm.

Por flitet edhe për gurin, vetëm,

gjithnjë në zonën arkeologjike

që nuk pranoi kurrë shkroja në faqen e vèt

e prèt pa droje stinën e shinave

e se për t'iu ndëgjue tingulli

do përplasë fort për tokë e hekur:

Andej del edhe nínulla e ûjës.⁴

Tekstet e *Palimpsest* janë të zgjidhura në planin metrik. Ndiqet fraza e kuptimet dhe jo vargu. Përfundimisht, ndiqet kompozicioni i tekstit. Frazja shtrihet përtej një vargu, për ta bartur vargun te tjetri e për ta mbuluar me tjetrin. Kuptimet shtrihen e mbivihen. Teksti shkon përtej vetes, paralajmëron tekstin që vjen pas/mbi dhe shtrihet si një palë e palimpsestit të Camajt. I gjithë libri është një palimpsest, drejt qendrës së të cilit arrihet duke qeruar shtresat si qerohet qepa. Çdo tekst është i plotë në vete, por i mbuluar nga tjetri, e tjetri. Kjo e bën *Palimpsest* një libër poetik të

⁴ Po aty, f. 26.

Camaj i (pa) zbuluem

strukturuar, një vepër që i detyrohet shumë teknikës retorike të strukturimit.

III. CAMAJ I ZBULUEM

Tashmë, si mund të formulohet në diskurs përgjithësues poetika e poezisë së Camajt?

Ç'emër merr qarku tematik i kësaj poezie?

Si hapen kuptimet?

Si e bën gjuha tekstin?

Camaj shenjon e skajon poetikën e tij te *Nji fyell ndër male e Kanga e vërrinit*, si tingull që buron nga kënga, por që nisat drejt shkrimit, si figurë që kujton frazën e vendit, por që ecën tutje, si gjuhë që rritet mbi idiolektin, por vetë sprovohet me gjuhën e librit. Kjo poetikë gjithnjë ecën drejt një *palimpsesti*. Çdo strukturë e formë e zbuluar përgjatë jetës letrare të Camajt mban si kujtesë format e para, nistore. Camaj është njeriu që mban mend e shkruan, për ta përcaktuar artin e vet si një fushë mnoematike.

Temat e Camajt janë tema të vendit e të personit, të emocionit e të kujtesës së tij. Të parat mbajnë brenda një ideologji sociale të pashpallur. Të dytat zbulojnë Camajn personal, por edhe Camajn në jetën me të tjerët. Të parat s'e bëjnë atë një poet social të afishuar. Të dytat e provojnë thellë si një lirik të përjetshëm.

Semantikisht teksti i Camajt ngarkohet e errësohet nga libri në libër, mban kuptimet thellë e s'pranon të flasë pa u provuar gjatë me to. Teksti i Camajt nuk flet pa e bërë të flasë. Camaj do lexues të duruar e të kultivuar.

Gegnishtja e Camajt provon veten nëpër kohët letrare të këtij autori. Gjithnjë duke u kultivuar në shkallë të re në planin gramatikor, metrik e poetik. Ai përherë e mat *gegnishten e tij* me *gegnishten e me gjuhën shqipe të librit të kohës*. Trajtat gramatikore shqyrtohen e ndryshojnë përherë. Bashkë me tingujt marrin funksion metrik. Gegnishtja poetike e Camajt e mban frazën idiomatike si një kujtesë e vetë bëhet gegnishte e librit. Po, se ajo pret të lexohet e jo të këndohet.

Përfundimisht, poetika e poezisë së Martin Camajt është një poetikë geqe, një pamje e Poetikës së shkrimit gegë, që ende s'është përshkruar e shijuar sistematikisht.

Ndërsa, është koha ta mbyllim këtë tekst për poezinë e Martin Camajt, këtë palimpsest, që mban si amzë thellë vetes poezinë e lexuar. Vetë Camaj ligjëronte:

Martin Camaj
Diptik

*Ishte koha me kthye andej kah erdha
te zanafilla dhe e mbylla librin
si mbyllen dy flegra dritaresh
dhe më doli para kuadri diptik
i thyem midis prej një kurrizore
ashti njeriu*

*dhe në të pasqyra e jetës nda përgjysë
poezi në dy fletë ku çdo fjalë
i shërben idesë 'palimpsest'.⁵*

⁵ Po aty, f. 68.